VENDIM
Nr. 23, datë 10.10.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Altin Binaj	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.9.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 1 (Dh) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Dhimitrulla Spiro

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 65, datë 29.9.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE**:** Nenet 4, 15, 17, 42, 43, 49, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE**,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave *(ILDKPKI)*, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi *(KED)*, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Dhimitrulla Spiro ka kandiduar në dy vende vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata)* të rishpallura nga Gjykata e Lartë në datën 3.6.2021.

2. Për efekt të procedurës së verifikimit të kandidatëve nga ana e KED-së kërkuesja duhej të plotësonte, mes të tjerash, edhe formularin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private, i cili duhej dorëzuar pranë ILDKPKI-së në afatin 15 ditë nga e nesërmja e pajisjes me të. Ajo është pajisur me këto dokumente në datën 15.7.2021.

3. Në datën 29.7.2021 kërkuesja, përmes shërbimit postar, ka dërguar formularin e deklarimit të pasurisë dhe interesave private pranë ILDKPKI-së, e cila me shkresën nr. 3221 prot., datë 2.8.2021 e ka kthyer pa veprim për shkak të mangësive në dokumentacion.

4. KED-ja, me vendimin nr. 4, datë 31.8.2021, ka vendosur: "*Ndalimin e kandidimit të kandidates Dhimitrulla Spiro për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 16.1.2021, 19.4.2019 dhe rishpallur në datën 3.6.2021.*". Gjithashtu, me vendimin nr. 5, datë 31.8.2021,

KED-ja ka vendosur: "*Ndalimin e kandidimit të kandidates Dhimitrulla Spiro për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datat 22.11.2018, 19.4.2019 dhe rishpallur në datën 3.6.2021.*". KED-ja ka arsyetuar se kërkuesja nuk plotëson një prej kushteve ligjore për kandidim, pasi nuk ka respektuar afatin ligjor 15-ditor për dorëzimin e deklaratës së plotësuar të pasurisë dhe interesave private.

5. Kërkuesja ka paraqitur ankim kundër vendimeve nr. 4 dhe nr. 5, datë 31.8.2021 të KED-së në Gjykatën Administrative të Apelit, duke kërkuar shfuqizimin e tyre, konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, shkresës nr. 3221 prot., datë 2.8.2021 të ILDKPKI-së dhe detyrimin e kësaj të fundit të pranojë e marrë në shqyrtim deklaratën e pasurisë së bashku me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe detyrimin e KED-së të vijojë procedurën e verifikimit të kushteve ligjore të kandidimit të saj. Kërkuesja ka kërkuar, gjithashtu, marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e procedurave të verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve për këto dy vakanca të shpallura nga Gjykata e Lartë.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 65, datë 29.9.2021, ka vendosur rrëzimin e padisë si në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e vendimeve nr. 4 dhe nr. 5, datë 31.8.2021 të KED-së, ashtu edhe për detyrimin e këtij organi për të vijuar me procedurën e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore për këtë kandidate, kurse në lidhje me kërkimet e tjera të kërkueses ka vendosur pushimin e gjykimit. Sipas dispozitivit të këtij vendimi, ai është përfundimtar dhe i formës së prerë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs, i cili është depozituar në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit në datën 22.11.2021.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 7.12.2021, ka vendosur: "*1. Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse Dhimitrulla Spiro kundër vendimit nr. 65, datë 29.9.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit. 2. Kundër këtij vendimi lejohet rekurs i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi të arsyetuar.*". Kundër këtij vendimi, në datën 24.12.2021, kërkuesja ka paraqitur rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-684, datë 17.3.2022, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e tij.

8. Ndërkohë që çështja ishte për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, me kërkesën e datës 11.3.2022 kërkuesja i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese sipas objektit të saj.

9. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 13.5.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Me kërkesat e datës 23.5.2022, drejtuar Kryetares së Gjykatës, 2 gjyqtare kanë kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak se në cilësinë e anëtareve të KED-së kanë marrë pjesë në shqyrtimin dhe vlerësimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kërkuesja, si dhe kanë shprehur qëndrimin e tyre në procedurat objekt i vendimeve të kundërshtuara prej saj. Për më tepër, që për njërën nga këto vakanca një prej gjyqtareve ka qenë anëtare relatore. Në datën 24.5.2022 ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes edhe Kryetarja e Gjykatës, për arsye se një nga vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, për të cilin ka kandiduar kërkuesja, është vendi i shpallur për zgjedhjen e pasardhësit të saj në detyrë.

10. Me vendimet nr. 6 dhe nr. 7 të datës 24.5.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur të pranojë kërkesat e paraqitura nga 2 gjyqtaret për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, kurse me vendimin nr. 8, të po kësaj date, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Kryetarja e Gjykatës.

11. Me vendimin e datës 24.5.2022, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

12. Me kërkesën e datës 24.6.2022, kërkuesja Dhimitrulla Spiro ka kërkuar përjashtimin nga gjykimi i kësaj çështjeje të 3 gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Mbledhja e Gjyqtarëve ka shqyrtuar kërkesën vetëm në lidhje me një prej tyre, pasi dy gjyqtaret e tjera kishin kërkuar ndërkohë heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, kërkesa të cilat janë pranuar *(shih paragrafin 10 të vendimit)*. Për këtë gjyqtar

kërkuesja ka pretenduar se ndodhet në rrethana ndaluese që e bëjnë të pamundur pjesëmarrjen e tij në gjykim, pasi ka qenë kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në të njëjtën procedurë në të cilën ka kandiduar edhe kërkuesja. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, me vendimin nr. 11, datë 26.7.2022, ka vendosur ta rrëzojë kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. Kërkuesja ka pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i janë cenuar:

13.1 *E drejta e aksesit*, në disa drejtime:

13.1.1 Gjykata Administrative e Apelit e ka pushuar çështjen për kërkimin e konstatimit të paligjshmërisë së veprimit administrativ të ILDKPKI-së, duke i mohuar kërkueses të drejtën për të parashtruar para gjykatës dhe për të marrë një vendim përfundimtar për këtë kërkim. Duke vendosur pushimin e gjykimit gjykata nuk e ka trajtuar kërkimin e kërkueses në kuadër të shkakut ligjor të tij, për pasojë nuk ka trajtuar as thelbin e tij, duke mos u shprehur me vendim themeli. Në kuptim të ligjit procedural vetëm konstatimi i legjitimimit pasiv të subjektit të interesuar në gjykim do të mund të sillte pushimin e gjykimit, ndërkohë që konstatimi i moskompetencës e detyron gjykatën ta dërgojë çështjen në gjykatën kompetente. Pavarësisht se në vetvete veprimi administrativ i ILDKPKI-së nuk ka sjellë pasoja direkte për kërkuesen, ka qenë kjo shkresë dhe ky veprim që kanë shërbyer si bazë për marrjen e vendimeve të KED-së. Veprimtaria e këtyre organeve gjatë verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve është totalisht e ndërvarur dhe është pjesë e së njëjtës procedurë.

*13.1.2 Kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi n*ë kushtet kur ILDKPKI-ja, në mënyrë të paligjshme, i ka kthyer deklaratën pa veprim, duke i mohuar aksesin në procedurat administrative, duhej të ishte KED-ja që të riparonte këto të meta dhe të pranonte dokumentacionin e vënë në dispozicion nga kërkuesja. *Sipas saj, është mohuar e drejta* e aksesit në procedurat administrative, si dhe e drejta për të rivendosur gjyqësisht pasojën e ardhur nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

13.1.3 Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, duke mos u shprehur në dispozitiv për të drejtën e ankimit për pjesën e padisë që është pushuar, ka vendosur përfundimisht humbjen e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë përgjigje për ato kërkime, duke i cenuar kështu edhe të drejtën e ankimit.

13.2 *Standardi i arsyetimit të vendimit,* si më poshtë:

13.2.1 Vendimi gjyqësor në lidhje me atë pjesë që ka vendosur pushimin e çështjes për njërin kërkim është kontradiktor, pasi, nga njëra anë, gjykata pretendon se nuk është kompetente, nga ana tjetër jo vetëm që nuk e dërgon çështjen në gjykatën kompetente, por e pushon atë. Kjo gjykatë që vetëdeklarohet jokompetente i hyn ligjshmërisë së shkresës nr. 3221 prot., datë 2.8.2021 të ILDKPKI-së, duke analizuar shkaqet ligjore të ngritura nga kërkuesja, siç janë momenti i dorëzimit të deklaratës, etj. Në asnjë pjesë të arsyetimit Gjykata Administrative e Apelit nuk ka mbajtur parasysh kriterin ligjor për kandidatët që në momentin e kandidimit janë subjekte deklaruese në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "**Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë**", të ndryshuar (*ligji nr. 9049/2003*), të cilët përjashtohen *ipso lege* nga detyrimi ligjor për të plotësuar dhe depozituar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së.

13.2.2 Gjykata Administrative e Apelit nuk ka ushtruar të drejtën që i njihet sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar *(ligji nr. 49/2012),* për të konstatuar paligjshmërinë, për pasojë jokushtetutshmërinë e udhëzimit "Mbi plotësimin e Dokumentit Zyrtar Deklaratë e Pasurisë dhe Interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të Drejtësisë", miratuar me urdhrin

nr. 284, datë 9.5.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm (*udhëzimi*), parashikimet e të cilit, në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve, bien ndesh me ato të ligjit organik të ILDKPKI-së. Kjo e fundit ka vepruar mbi bazën e këtij akti nënligjor duke vendosur mospranimin e deklaratës së pasurisë së kërkueses. ILDKPKI-ja, në mënyrë të paligjshme, i ka kthyer kërkueses deklaratën e saj pa veprim, duke i mohuar aksesin në procedurat administrative. Veprimet e kërkueses konfirmonin vullnetin e saj për të mos iu shmangur detyrimit, edhe pse ajo ishte subjekt që nuk duhej t`i nënshtrohej kontrollit, pasi që prej vitit 2004, kur ka filluar punë në detyrën e inspektores në ILDKPKI, dhe deri në vitin 2021 ka qenë subjekt deklarimi dhe ka kryer deklarimet vjetore të pasurisë. Bazuar edhe në pikën 2 të nenit 3/1 të ligjit nr. 9049/2003, kërkuesja ka paraqitur në gjykim shkresën nr. 3071 prot., datë 2.7.2021 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, që vërteton se në momentin e aplikimit për kandidim ajo i ishte nënshtruar plotësisht kontrollit të pasurisë në përputhje me ligjin.

13.2.3 Me një interpretim joligjor dhe jokushtetues, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se përdorimi i terminologjisë "dorëzim" nënkupton paraqitjen personalisht dhe dorëzimin e deklaratës fizikisht nga subjekti pranë institucionit, çka bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative (*KPA*) për dorëzimin e akteve. Po kështu, gjykata ka dështuar në konstatimin e shkeljeve ligjore të bëra nga ILDKPKI-ja, e cila kishte detyrimin ligjor, në bazë të ligjit nr. 9049/2003, që menjëherë sapo të merrte në dorëzim dhe shqyrtim deklaratën e pasurisë, të njoftonte kërkuesen për të metat e konstatuara dhe t`i linte afat për plotësimin e tyre. Përkundrazi, ky organ ka refuzuar të merrte në dorëzim edhe dokumentet plotësuese të deklaratës së pasurisë.

13.2.4 Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shteruar interpretimin nëse udhëzimi, mbi bazën e të cilit ka vepruar ILDKPKI-ja, është ose jo akt nënligjor me fuqi detyruese ndaj subjektit deklarues dhe nëse është zbatuar parimi i hierarkisë së normave. Ajo i ka kaluar barrën e provës kërkueses pa filluar verifikimi nga ky institucion kontrollues, ndërkohë që me ndryshimet e vitit 2014 të ligjit nr. 9049/2003, kjo barrë i është kaluar ILDKPKI-së, për rrjedhojë në këtë procedurë verifikimi edhe KED-së.

13.3 *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, i cili, në kuptimin substancial, nënkupton të drejtën e subjektit kandidues (kërkueses) për t'u konsideruar nga shoqëria, publiku dhe organet e procedimit, konkretisht KED-ja, si i pafajshëm në kuptimin administrativ. Kjo nënkupton pushtetin për të kërkuar që të konsiderohet dhe shihet si i pafajshëm gjatë gjithë periudhës së procedimit, derisa me vendim të formës së prerë të vendoset nëse është i pafajshëm ose fajtor. Në kundërshtim me këtë parim, ILDKPKI-ja, KED-ja dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë mbajtur parasysh faktin që gjatë shqyrtimit gjyqësor është provuar se kërkuesja, për shkak të pozicionit të punës, i është nënshtruar në vijimësi kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI-ja. Po kështu, nuk mund të vihej në dyshim qëndrimi i saj ndaj institucioneve për efekt të kontrollit dhe kërkuesja ka shfaqur vullnetin e plotë për të paraqitur deklaratën dhe dokumentet mbështetëse. Procedurat e ndjekura nga KED-ja dhe vendimmarrjet e saj pa një hetim të plotë, bazuar në një "akuzë" ende të pakonfirmuar nga ILDKPKI-ja, kanë paragjykuar çështjen dhe kanë prezumuar paligjshmërinë e veprimit administrativ të kësaj të fundit.

13.4 *Parimi i sigurisë juridike dhe e drejta për zgjidhje efektive*, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ka sjellë vënien në zbatim të dy akteve administrative me karakter ndalues. Po kështu, ky vendim i ka ngarkuar kërkueses detyrime që nuk janë parashikuar në ligj dhe e ka vendosur në pozita të pasigurta juridike, për aq kohë sa në mënyrë përfundimtare dhe të paligjshme i ka ndaluar kandidimin për vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese. ILDKPKI-ja nuk ka arritur të provonte në këtë proces faktet dhe ligjin ku janë bazuar veprimet e saj. Edhe KED-ja është mjaftuar vetëm me veprimet e refuzimit të ILDKPKI-së për të kryer kontrollin e pasurisë. Edhe pse KED-ja, në kuptim edhe të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ),* gëzonte tagrat ligjore/mjetet efektive për të korrigjuar paligjshmërinë e veprimit të ILDKPKI-së, ka zgjedhur të mos i ushtrojë ato. Ajo i ka ngarkuar kandidates detyrimin për të plotësuar deklaratën e pasurive pa

konstatuar se në kuptim të ligjit mbi këtë të fundit nuk rëndonte asnjë detyrim për shkak të përjashtimit ligjor eksplicit. Autoritetet publike dhe gjykata kanë dështuar në vlerësimin e përmbushjes ose jo të kërkesave ligjore nga kërkuesja, duke e përjashtuar/ndaluar kandidimin e saj *a priori*, në mënyrë të paligjshme, edhe pse plotësonte të gjitha kushtet për të qenë pjesë e kësaj procedure.

13.5 *Parimi i proporcionalitetit*, pasi ndalimi për të kandiduar për vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese jo vetëm ndikon thelbësisht në të drejtën për zhvillim profesional të kërkueses, por ka përmasa të tilla që asgjëson krejtësisht këtë të drejtë themelore, duke i shkaktuar një dëm individual të përmasave të mëdha. Nuk është ruajtur një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti mes mjeteve të përdorura dhe qëllimeve të ndjekura, të cilat edhe pse prezumohet se diktohen nga interesi publik nuk mund të kryhen në kundërshtim ose tejkalim të ligjit, aq më pak të cenojnë të drejtat ligjore e kushtetuese të kërkueses. Në këtë rast janë cenuar jo vetëm të drejtat e kërkueses, por edhe interesi publik për zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

13.6 *E drejta për profesion dhe rritje profesionale*, e garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës, për rrjedhojë edhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, sipas nenit 8 të KEDNJ-së, pasi vendimmarrjet e organeve administrative dhe atyre gjyqësore nuk i kanë garantuar kërkueses të drejtën për të marrë pjesë në konkurrim, pavarësisht se i plotësonte të gjitha kriteret ligjore për të qenë kandidate për gjyqtare kushtetuese.

14. Subjekti i interesuar, ILDKPKI-ja, ka prapësuar si vijon:

14.1 Gjykata Administrative e Apelit ka respektuar të drejtën e aksesit në gjykim, pasi ka marrë në shqyrtim padinë e paraqitur nga kërkuesja, e ka dëgjuar dhe i ka dhënë mundësinë të parashtrojë të gjitha pretendimet gjatë gjykimit, ka administruar dhe shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura, por edhe ka lejuar paraqitjen e provave shtesë nga kërkuesja. Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar në tërësi aktet e organeve shtetërore që ishin objekt gjykimi dhe me vendimmarrjen e saj ka përmbushur funksionin e realizimit të drejtësisë. Vendimi nr. 65, datë 29.9.2021, i Gjykatës Administrative të Apelit është i drejtë dhe i arsyetuar.

14.2 Ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar (*ligji nr. 115/2016*) kufizon të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të KED-së, duke përcaktuar qartë se ato mund të ankimohen vetëm në rastet e shkeljeve të rënda procedurale, si dhe duke përcaktuar juridiksionin fillestar të Gjykatës Administrative të Apelit. E drejta e ankimit mund të kufizohet me ligj për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, pa e cenuar procesin e rregullt ligjor. Kërkuesja e ka ushtruar të drejtën e ankimit, pasi ka paraqitur rekurs ndaj vendimit nr. 65, datë 29.9.2021.

14.3 Pretendimet e kërkueses referohen në analizën e fakteve dhe rrethanave të themelit të gjykimit të kryer në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe kanë të bëjnë me vlerësimin e provave të administruara në gjykim, të cilat bien në kundërshtim me natyrën e procesit kushtetues. Procesi i kandidimit dhe emërimit në pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese është një procedurë administrative në kompetencë të KED-së si organ kolegjial dhe asnjë organ tjetër publik nuk ka fuqi ose kompetencë vendimmarrëse mbi këtë procedurë, aq më pak ILDKPKI-ja. Vendimmarrja që i ka ndaluar kandidimin kërkueses i përket KED-së, që është organi i vetëm i cili mund të rivendosë potencialisht të drejtën e pretenduar si të cenuar.

14.4 Shkresa e kundërshtuar e ILDKPKI-së nuk përbën vendimmarrje në lidhje me procedurën për kandidim të kërkueses. Kjo shkresë e aluduar si veprim ose akt administrativ përbën një shkresë përcjellëse njoftuese me qëllim njoftimin e kërkueses për gjendjen e depozitimit të akteve të saj pranë këtij organi publik dhe njoftimin e faktit se deklarata e saj është kthyer pa veprim. Jo çdo shkresë që del nga organi publik përbën *a priori* një akt ose veprim administrativ.

14.5 Kërkuesja ka qenë në dijeni të plotë se deklarata e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë duhej të shoqërohej me dokumentacionin justifikues, pra pretendimi i saj në këtë rast është i gabuar dhe i pambështetur në

prova dhe ligj. Ajo ka pasur njohuri të posaçme në këtë fushë, për shkak të detyrës së saj dhe i njihte pasojat që sillte mosdorëzimi i deklaratës sipas parashikimeve ligjore.

15. Subjekti i interesuar, ***KED-ja***, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

16. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

17. Kërkuesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të saj, legjitimohet *ratione personae* për kërkimet sipas objektit të kërkesës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor që kundërshtohet, për rrjedhojë provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Një tjetër kriter, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i kësaj dispozite kushtetuese është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese *(shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 23, datë 29.4.2021; nr. 54, datë 24.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll *subsidiar*, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Pra, para se kërkuesi t'i drejtohet Gjykatës, ai duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton se kërkuesi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, vëren se në dispozitivin e vendimit nr. 65, datë 29.9.2021 Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se ai është një vendim përfundimtar dhe i formës së prerë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs, për të cilin Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 7.12.2021, ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se ekzistojnë kushtet ndaluese për ushtrimin e tij, në kuptim të përmbajtjes së pikës 2 të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, që parashikon se vendimi me të cilin disponohet në lidhje me ankimin kundër

vendimit të KED-së për ndalimin e kandidimit është përfundimtar dhe i formës së prerë, rregull i shprehur procedural që nuk lejon të paraqitet rekurs ose rekurs i veçantë.

21. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë në datën 24.12.2021, duke pretenduar cenimin e interesave të saj të ligjshme dhe të së drejtës së aksesit. Me vendimin nr. 00-2022-684, datë 17.3.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të veçantë, bazuar në analizën dhe interpretimin e nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, konkretisht të frazës "*vendim përfundimtar dhe i formës së prerë*", me arsyetimin se e gjithë fryma e hartimit të kësaj dispozite dhe dispozitave të ngjashme të këtij ligji dukshëm garantojnë statusin e një vendimi përfundimtar, të parekursueshëm dhe menjëherë të ekzekutueshëm dhe se një interpretim i ndryshëm do e bënte dispozitën të pakuptimtë dhe të pazbatueshme. Sipas Gjykatës së Lartë "*neni 238 i ligjit nr. 115/2016 ndjek një qëllim legjitim dhe proporcional në kufizimin e së drejtës së rekursit, pasi dispozita përkatëse mishëron qëllimin e ligjvënësit për përfundimin në një kohë sa më të shpejtë të procesit kushtetues të përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në funksion të zhbllokimit të procesit të formimit të kësaj Gjykate dhe miradministrimit të tërësor të sistemit të drejtësisë*) (*shih paragrafin 45 të vendimit të Kolegjit Administrativ*). Më tej, Kolegji Administrativ ka marrë në shqyrtim dhe u ka dhënë përgjigje, në kuptim të përmbajtjes së nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), pretendimeve të parashtruara në rekurs për mosrespektim të ligjit procedural lidhur me kompetencën e gjykatës së apelit për të vendosur mospranimin e rekursit.

22. Për sa më sipër, edhe pse kërkuesja e ka paraqitur ankimin kushtetues individual në Gjykatë përpara vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në kushtet kur objekt kërkese është vendimi i themelit i Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata vlerëson se kërkuesja i ka shteruar të gjitha mjetet e ankimit që i njeh legjislacioni në fuqi përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Për më tepër, Gjykata vëren se ligji ka përcaktuar natyrën e këtyre vendimeve si përfundimtare dhe të formës së prerë, duke kufizuar në këtë mënyrë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Lartë, prandaj kërkueses nuk mund t'i kërkohet shterimi i rekursit, si mjet ankimi, përpara paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

23. Kufizimi i së drejtës së ankimit, sipas nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ndjek një qëllim legjitim dhe proporcional në kufizimin e së drejtës së rekursit, duke përcaktuar natyrën e këtyre vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit si menjëherë të ekzekutueshëm. Qëllimi i ligjvënësit në hartimin e kësaj dispozite është përfundimi i procesit kushtetues të përzgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese në një kohë të shkurtër si dhe plotësimi e formimi i kësaj Gjykate. Për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar se edhe ankimet ndaj vendimeve të KED-së për ndalimin e kandidimit, të ushtruara në Gjykatën Administrative të Apelit, shqyrtohen brenda afatit 7-ditor në këtë gjykatë vetëm për shkelje të rënda procedurale, duke u fokusuar në rastet e paligjshmërisë së vendimmarrjes së Këshillit, si dhe, për më tepër, sipas pikës 3 të nenit 238 të këtij ligji, ky ankim nuk i pezullon procedurat administrative. Pra, e gjithë fryma e hartimit të kësaj dispozite justifikon interesin publik në funksion të administrimit të procesit brenda afateve të arsyeshme të formimit të kësaj Gjykate.

24. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se KED-ja, për sa i përket natyrës dhe mënyrës së funksionimit, është organ kushtetues i pavarur me kompetenca të njohura me ligj, që kryen verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Në lidhje me ankimet kundër vendimit të KED-së për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit konsiderohet si ankim në një gjykatë më të lartë në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës.

25. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) është shprehur se rregullat që disiplinojnë hapat formalë për paraqitjen e një ankimi synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë. Sipas saj, thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë cenohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimeve të "sigurisë juridike" dhe "administrimit të duhur të drejtësisë" dhe formojnë një lloj pengese që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente *(shih vendimin Zubac kundër Kroacisë [GC], datë 5.4.2018, § 98).* Në veçanti, çështjet e

"sigurisë juridike" dhe "administrimit të duhur të drejtësisë" janë dy elemente kryesore për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale *(po aty)*. Në shqyrtimin e proporcionalitetit të kufizimit të aksesit në gjykatë, GJEDNJ-ja merr parasysh gabimet procedurale të kryera gjatë procedurave, të cilat e penguan kërkuesin të gëzonte një akses të tillë dhe përcakton nëse kërkuesi ishte detyruar të mbante një barrë të tepruar për shkak të këtyre gabimeve (*po aty, §§ 90-95, 119)*. Aty ku janë bërë gabime para gjykatave më të ulëta, GJEDNJ-ja ka vlerësuar rolin e mëvonshëm të Gjykatës së Lartë *(po aty, §§ 122–124)* (*shih vendimin nr. 6, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në lidhje me pretendimin e kërkueses se duke vendosur pushimin e gjykimit Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka trajtuar kërkimin për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, shkresës nr. 3221 prot., datë 2.8.2021 të ILDKPKI-së dhe detyrimin për të marrë në shqyrtim deklaratën e pasurisë së bashku me dokumentacionin justifikues, Gjykata konstaton se ligji nr. 115/2016 parashikon shprehimisht se gjatë procesit administrativ të verifikimit të plotë të pasurisë së kandidatit për në Gjykatën Kushtetuese, KED-ja ndihmohet nga ILDKPKI-ja si organi kompetent i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarimit, verifikimin e pasurisë, dhe përgatit raportin përkatës e paraqet çdo informacion, dokumentacion ose material tjetër në lidhje me këtë hetim të kërkuar nga KED-ja. Pavarësisht se në këtë proces janë të përfshira dy organe administrative të ndryshme, Gjykata e konsideron atë si një proces të vetëm në të cilin KED-ja ka rol vendimmarrës, ndërsa ILDKPKI-ja përfshihet si një organ ndihmës. Prandaj, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses në këtë drejtim do të shihen në këndvështrim të procesit administrativ në tërësinë e tij.

27. Për sa i përket legjitimimit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Nisur nga vendimmarrja e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mbi kufizimin e së drejtës së rekursit, kërkuesja nëpërmjet ankimit kushtetues individual ka kundërshtuar vetëm vendimin e themelit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke konsideruar si moment të konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, pra të fillimit të afatit ligjor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, datën në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë efektivisht i disponueshëm për të dhe kur ajo është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e asaj gjykate. Sipas akteve bashkëlidhur kërkesës (shkresa nr. 570/1 prot., datë 12.5.2022 e filialit të Postës Shqiptare për dorëzimin e vendimit të gjykatës së apelit) dhe përmbajtjes së vendimeve gjyqësore, rezulton se vendimi i kundërshtuar i është njoftuar kërkueses në datën 16.11.2021, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.3.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të lartpërmendur.

28. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuesja ka parashtruar në kërkesë disa pretendime me natyrë procedurale që lidhen me cenimin e së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në disa aspekte të saj, konkretisht e drejta e aksesit, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimi i prezumimit të pafajësisë, si dhe pretendime me natyrë materiale, si ai që lidhet me cenimin e parimit të sigurisë juridike, parimit të proporcionalitetit dhe së drejtës për profesion dhe rritje profesionale. Po kështu, kërkuesja, mbi të njëjtat fakte, parashtron argumente edhe për procedurën administrative të zhvilluar nga KED-ja, edhe pse pretendimet e saj, në thelb, lidhen me vendimmarrjen e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila nuk ka riparuar shkeljet e kryera nga organet administrative.

29. Kërkuesja, gjithashtu, është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit, duke vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar kundër vendimit të po asaj gjykate, ka tejkaluar kompetencat, pasi, edhe pse është kompetente për të shqyrtuar vetëm kushtet formale të rekursit, të cilat janë plotësuar në rastin konkret, me një interpretim të zgjeruar dhe në kundërshtim me ligjin, ka marrë në shqyrtim edhe faktin nëse ndaj vendimit të ankimuar mund të ushtrohet rekurs. Sipas kërkueses, vendimi ndaj të cilit është paraqitur rekurs nuk përfshihet në listën shteruese të përcaktuar në nenin 56 të ligjit nr.

49/2012 dhe neni 238 i ligjit nr. 115/2016 nuk përcakton në mënyrë të shprehur se ndaj këtyre vendimeve nuk mund të paraqitet rekurs.

30. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit i datës 7.12.2021, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk rezulton të jetë objekt kundërshtimi i ankimit kushtetues individual, prandaj ajo nuk do të analizojë pretendimet e kërkueses në lidhje me këtë vendim.

31. Në lidhje me të drejtën për proces të rregullt ligjor, kërkuesja, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi organet administrative dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk kanë mbajtur parasysh faktin se ajo, për shkak të pozicionit të punës, i është nënshtruar në vijimësi kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI-ja dhe as vullnetin e plotë të shfaqur nga kërkuesja për të paraqitur deklaratën dhe dokumentet mbështetëse. Po kështu, sipas saj, procedurat e ndjekura nga KED-ja dhe vendimmarrjet e saj pa një hetim të plotë, bazuar në një "akuzë" ende të pakonfirmuar nga ILDKPKI-ja, kanë paragjykuar çështjen dhe kanë prezumuar paligjshmërinë e veprimit administrativ të kësaj të fundit.

32. Parimi i prezumimit të pafajësisë sanksionohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në lidhje me zbatimin e këtij parimi, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në rastet e shkarkimit të funksionarëve të lartë kushtetues parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të paanësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, kur organet e ngarkuara me këto procedura, qoftë në përbërjen dhe organizimin e tyre, qoftë në veprimtarinë e funksionet e tyre, nuk mund të jenë organe gjyqësore, nuk ushtrojnë pushtet gjyqësor, por ushtrojnë pushtete të tjera të ndryshme (*shih vendimet nr. 25, datë 10.5.2021; nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata çmon se në procedurat administrative që zhvillohen gjatë verifikimit të kritereve ligjore për kandidatët për funksionet kushtetuese KED-ja zhvillon një proces administrativ, i cili ka parimet e veta që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e shkaqeve konkrete që i shërbejnë për të marrë vendimet përkatëse. Ky proces duhet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Megjithatë, parimi i prezumimit të pafajësisë në këtë procedurë nuk mund të gjejë zbatim si në procesin gjyqësor penal apo atë disiplinor, për shkak të natyrës administrative të saj. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkueses nuk është arritur të ngrihet në nivel kushtetues.

34. Kërkuesja, gjithashtu, ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës për zgjidhje efektive, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit ka sjellë si pasojë vënien në zbatim të dy akteve administrative me karakter ndalues. Sipas saj, ky vendim i ka ngarkuar detyrime ligjore, të cilat nuk janë të sanksionuara në ligj dhe e ka vendosur në pozita të pasigurta juridike, për aq kohë sa në mënyrë përfundimtare dhe të paligjshme i ka ndaluar kandidimin për vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese. Edhe pse KED-ja, në kuptim edhe të nenit 13 të KEDNJ-së, gëzonte tagrat ligjore/mjetet efektive për të korrigjuar paligjshmërinë e veprimit të ILDKPKI-së, ka zgjedhur të mos i ushtrojë ato, duke i ngarkuar kërkueses detyrimin për të plotësuar deklaratën e pasurive, edhe pse ajo përjashtohej nga ky detyrim.

35. Në lidhje me këtë pretendim kërkuesja nuk ka arritur të argumentojë në nivel kushtetues se në cilin aspekt të parimit të sigurisë juridike është cenuar nga vendimet e organeve administrative dhe të gjykatës, pra se cilat kanë qenë të drejtat e fituara ose pritshmëritë e ligjshme të saj të garantuara nga legjislacioni në fuqi, ndërkohë që këto pretendime lidhen thelbësisht me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit në çështjen konkrete, si dhe me vlerësimin e fakteve dhe rrethanave, të cilat janë çështje që nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues nëse nuk provohet se kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve.

36. Gjykata vlerëson se edhe pretendimet e kërkueses për cenimin e parimit të hierarkisë së akteve ligjore, për arsye se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka zbatuar nenin 38 të ligjit nr. 49/2012 për të konstatuar paligjshmërinë e udhëzimit mbi bazën e të cilit ka vepruar ILDKPKI-ja, duke i kaluar

barrën e provës kërkueses, si edhe në lidhje me mënyrën e interpretimit nga Gjykata Administrative e Apelit të termit "dorëzim", janë me natyrë ligjore dhe kërkuesja nuk ka arritur t`i ngrejë në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojë cenimin e të drejtave ose parimeve kushtetuese. Për rrjedhojë, këto pretendime, si të tilla, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj nuk mund të merren në shqyrtim.

37. Kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e parimit të proporcionalitetit, pasi ndalimi për të kandiduar për vakancat e krijuara në Gjykatën Kushtetuese jo vetëm ndikon thelbësisht në të drejtën për zhvillim profesional të saj, por ka përmasa të tilla që asgjëson krejtësisht këtë të drejtë themelore, duke i shkaktuar dëm individual. Sipas saj, nuk është ruajtur një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti mes mjeteve të përdorura në kundërshtim me ligjin dhe qëllimeve të ndjekura, të cilat edhe pse prezumohet se diktohen nga interesi publik nuk mund të kryhen në kundërshtim ose tejkalim të ligjit, aq më pak të cenojnë të drejtat legjitime ligjore e kushtetuese të kërkueses. Këtë parim kërkuesja e ndërlidh me të drejtën për zhvillim profesional të saj, për të cilën argumenton se vendimmarrjet e organeve administrative dhe atyre gjyqësore nuk i kanë garantuar të drejtën për të marrë pjesë në konkurrim, pavarësisht se i plotësonte të gjitha kriteret ligjore për të qenë kandidate për gjyqtare kushtetuese, duke i cenuar kështu të drejtën për profesion dhe rritje profesionale, për rrjedhojë edhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

38. Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim, pasi nuk është arritur të argumentohet se në çfarë mënyre skualifikimi i kërkueses si kandidate për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese përfshihet në fushën e veprimit të të drejtave kushtetuese dhe konventore të pretenduara të cenuara.

39. Po në kuptim të legjitimimit *ratione materiae*, pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesja, që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit, janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, prandaj Gjykata në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

*40. Kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit, pasi n*ë kushtet kur ILDKPKI-ja, në mënyrë të paligjshme, i ka kthyer deklaratën pa veprim, duke i mohuar aksesin në procedurat administrative, duhej të ishte KED-ja që të riparonte këto të meta dhe të pranonte dokumentacionin e vënë në dispozicion nga kërkuesja. *Sipas saj është mohuar e drejta* e aksesit në procedurat administrative, si dhe e drejta për të rivendosur gjyqësish pasojën e ardhur nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor.

41. Subjekti i interesuar, ILDKPKI-ja, ka prapësuar se Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim padinë e paraqitur nga kërkuesja, e ka dëgjuar dhe i ka dhënë mundësinë të parashtrojë të gjitha pretendimet gjatë gjykimit, ka administruar dhe shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura, si dhe ka lejuar paraqitjen e provave shtesë asaj. Ajo ka shqyrtuar në tërësi aktet e organeve shtetërore që ishin objekt gjykimi dhe me vendimmarrjen e saj ka përmbushur funksionin e realizimit të drejtësisë. Vendimmarrja që i ka ndaluar kandidimin kërkueses i përket KED-së, që është organ i vetëm i cili mund të rivendosë potencialisht të drejtën e pretenduar të cenuar.

42. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar

një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Gjykata vëren se kërkuesja ka kandiduar për dy pozicione të shpallura nga Gjykata e Lartë për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Në vijim të procedurave të zhvilluara nga KED-ja, ajo është paraqitur pranë këtij organi për tërheqjen e formularëve standardë të deklarimit dhe autorizimeve përkatëse, mes të cilëve edhe ai për deklarimin e pasurisë dhe të interesave private, që bazuar në nenin 235, pika 2, të ligjit nr. 115/2016, duhej dorëzuar e plotësuar pranë ILDKPKI-së jo më vonë se 15 ditë nga marrja e tij. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. 3211/1 prot., datë 2.8.2021, ka njoftuar KED-në se kandidatja Dhimitrulla Spiro konsiderohet se nuk e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë brenda afatit ligjor, pasi nuk është shoqëruar nga dokumentacioni ligjor (certifikata, letërnjoftimi dhe dokumentet justifikuese).

44. Në datën 3.8.2021, nëpërmjet komunikimit elektronik, KED-ja e ka njoftuar kërkuesen për sa më sipër, duke e ftuar që brenda datës 9.8.2021 të paraqiste shpjegime ose pretendime me shkrim për shkaqet e mosparaqitjes së deklaratës së pasurisë dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj. Në datën 4.8.2021 kërkuesja ka parashtruar nëpërmjet *e-mail*-it se deklarata e pasurisë është paraqitur veçmas, nëpërmjet shërbimit postar, brenda afatit ligjor, konkretisht në datën 29.7.2021, kurse dokumentacioni ligjor shoqërues është paraqitur dorazi prej saj ditën e fundit të afatit ligjor, konkretisht në datën 30.7.2021, por nuk është marrë në dorëzim nga ana e ILDKPKI-së.

45. Në datën 23.8.2021 relatorja ka përgatitur relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar për kërkuesen, që së bashku me materialet e kësaj procedure i janë dërguar për shqyrtim mbledhjes së KED-së, e cila në datën 31.8.2021, me vendimet nr. 4 dhe nr. 5, ka vendosur ndalimin e kandidimit të kandidates Dhimitrulla Spiro në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosrespektimit të një prej kushteve ligjore të kandidimit, detyrimit të pikës 2 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, për dorëzimin e deklaratës së pasurisë të plotësuar pranë ILDKPKI-së brenda afatit ligjor. Këto vendime i janë njoftuar kërkueses nga KED-ja, por, duke mos qenë dakord me to, ajo i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit.

46. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 65, datë 29.9.2021, ka vendosur të rrëzojë padinë në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e vendimeve të KED-së nr. 4 dhe nr. 5, datë 31.8.2021 dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimet për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ të ILDKPKI-së.

47. Gjykata vëren se edhe pse kërkuesja në objektin e kërkesës ka kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, në përmbajtje të saj ka ngritur pretendime edhe në lidhje me procesin e zhvilluar nga KED-ja, e cila, edhe pse kishte mundësitë dhe mjetet ligjore, nuk ka riparuar shkeljet e konstatuara nga ILDKPKI-ja. Në thelb, pretendimet e kërkueses bazohen mbi të njëjtat fakte që kanë cenuar të drejtat e saj dhe parimet kushtetuese gjatë procedurës administrative, të cilat nuk janë riparuar gjatë procesit gjyqësor.

48. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë

e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur *(shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 25, datë 10.5.2021; nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese)*.

49. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata do të analizojë respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit, si në procesin administrativ të zhvilluar në KED, ashtu edhe në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit.

50. Gjykata vëren se gjatë procesit administrativ të zhvilluar nga KED-ja, kërkuesja e ka realizuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur *nëpërmjet komunikimit të akteve, përfshirë ato të ILDKPKI-së. Asaj i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegime dhe* pretendime me shkrim për shkaqet e mosparaqitjes së deklaratës së pasurisë dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, dhe në përfundim të procedurës administrative KED-ja ka parashtruar në vendimet për ndalimin e kandidimit të kërkueses jo vetëm procedurën e ndjekur, por edhe bazën ligjore mbi të cilën ka bazuar vendimmarrjen e saj, analizën ligjore, duke u dhënë përgjigje edhe pretendimeve të kërkueses në lidhje me aktet e zbatueshme në rastin konkret, si edhe në lidhje me mospranimin nga ana e ILDKPKI-së të dokumentacionit mbështetës të paraqitur personalisht prej saj.

51. Në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykata vëren se sipas nenit 238, pika 1, të ligjit nr. 115/2016, ankimet kundër vendimit të KED-së për ndalimin e kandidimit bëhen vetëm për shkelje të rënda procedurale, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Ligjvënësi e ka kufizuar të drejtën e ankimit në këtë rast vetëm në drejtim të shkeljeve të rënda procedurale, duke mos lejuar kontrollin gjyqësor të këtyre lloj vendimesh për pretendime që kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit mbi të cilin bazohet vendimmarrja e KED-së.

52. Gjykata Administrative e Apelit, në përputhje me juridiksionin e saj të kufizuar për shqyrtimin e këtyre çështjeve, ka marrë në konsideratë pretendimet e kërkueses që kanë të bëjnë me procedurën e zhvilluar nga KED-ja dhe u ka dhënë atyre përgjigje përfundimtare. Ajo ka shqyrtuar edhe bazën ligjore të zbatueshme në rastin konkret, nga e cila buron detyrimi i subjekteve për të paraqitur dokumentacionin përkatës, rastet përjashtimore në të cilat subjektet nuk kanë detyrimin për t'iu nënshtruar kontrollit të pasurisë, si edhe pretendimin në lidhje me mospranimin e dokumentacionit mbështetës nga ana e ILDKPKI-së.

53. Për sa më sipër, Gjykata çmon se në ndryshim nga sa pretendon kërkuesja, Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në përputhje me kompetencat e saj dhe brenda kufijve të njohur nga ligji, duke mos i cenuar kërkueses të drejtën për të pasur lirisht akses në gjykatë dhe për të marrë përgjigje përfundimtare për pretendimet e saj. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

54. Sipas kërkueses është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit, pasi në asnjë pjesë të tij nuk është mbajtur parasysh kriteri ligjor për sa u përket kandidatëve që në momentin e kandidimit janë subjekte deklaruese në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 9049/2003, të cilët janë *ipso lege* të përjashtuar nga detyrimi ligjor për të plotësuar dhe depozituar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së. Sipas saj, gjykata nuk ka ushtruar të drejtën që i njihet sipas nenit 38 të ligjit nr. 49/2012 për të konstatuar paligjshmërinë e udhëzimit mbi bazën e të cilit ka vepruar ILDKPKI-ja, parashikimet e të cilit, në kundërshtim me parimin e hierarkisë së akteve, bien ndesh me ato të ligjit organik të ILDKPKI-së.

55. Po kështu, ajo pretendon se Gjykata Administrative e Apelit me një interpretim joligjor dhe jokushtetues ka arsyetuar se përdorimi i terminologjisë "dorëzim" nënkupton të paraqiturin personalisht dhe dorëzimin e deklaratës fizikisht nga subjekti pranë institucionit, çka bie në kundërshtim me dispozitat e KPA-së për dorëzimin e akteve. Gjykata jo vetëm ka dështuar në

konstatimin e shkeljeve ligjore të bëra nga ILDKPKI-ja, e cila kishte detyrimin ligjor që ta njoftonte kërkuesen për të metat e konstatuara dhe t`i jepte afat për plotësimin e tyre, por nuk është shprehur nëse udhëzimi, mbi bazën e të cilit ka vepruar ILDKPKI-ja, është ose jo akt nënligjor me fuqi detyruese ndaj subjektit deklarues, sipas parimit të hierarkisë së normave. Ajo i ka kaluar barrën e provës kërkueses pa filluar verifikimi nga ky institucion kontrollues, ndërkohë që me ndryshimet e vitit 2014 të ligjit nr. 9049/2003, kjo barrë i është kaluar ILDKPKI-së dhe, për rrjedhojë, në këtë procedurë verifikimi edhe KED-së.

56. Subjekti i interesuar, ILDKPKI-ja, ka prapësuar se kërkuesja ka qenë në dijeni të plotë se deklarata e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë duhej të shoqërohej me dokumentacionin justifikues, pra pretendimi i saj në këtë rast është i gabuar dhe i pambështetur në prova dhe ligj. Kërkuesja ka pasur njohuri të posaçme në këtë fushë për shkak të detyrës së saj dhe i njihte pasojat që sillte mosdorëzimi i deklaratës sipas parashikimeve ligjore. Ajo, edhe për shkak të detyrës së saj, ka qenë në dijeni se deklarata e pasurisë dhe e interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë duhet të shoqërohej me dokumentacionin justifikues dhe njihte edhe pasojat e mospërmbushjes së këtij detyrimi.

57. Gjykata e ka vlerësuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor si një detyrim të sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së saj. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë *(shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, çka mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por, në aspektin e kontrollit kushtetues, ajo verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar *(shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Bazuar në standardet e mësipërme dhe analizën e çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se ky pretendim i kërkueses, të cilin ajo e ka parashtruar vetëm në drejtim të procesit gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit, është i pabazuar. Nga përmbajtja e vendimit të kundërshtuar konstatohet se ai përmban të dhënat e palëve, shkaqet e ngritura në padinë që e ka vënë në lëvizje, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata ka mbështetur qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Në këndvështrim të standardit të arsyetimit, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të kërkueses në lidhje me procedurën e ndjekur nga KED-ja, si dhe ka parashtruar argumentet e saj për rrëzimin e këtyre pretendimeve. Për pasojë, vendimi i gjykatës së apelit nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtje.

60. Lidhur me pretendimin e kërkueses se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka analizuar parasysh kriterin ligjor për kandidatët që në momentin e kandidimit janë subjekte deklaruese në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 9049/2003, të cilët përjashtohen nga detyrimi ligjor për të plotësuar dhe depozituar deklaratën e pasurisë pranë ILDKPKI-së, Gjykata vëren se pika 2 e nenit 3/1 të ligjit nr.

9049/2003 parashikon: "*Kandidatët për pozicionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, që janë subjekte që mbartin detyrimin për deklarimin e interesave privatë, sipas parashikimeve të nenit 3 të këtij ligji, nuk kryejnë deklarim të ri, por i nënshtrohen kontrollit të plotë të pasurisë. Nëse gjatë 180 ditëve para paraqitjes së kërkesës, kandidati është kontrolluar nga ILDKPKI-ja dhe kontrolli nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë kontrolli konsiderohet i kryer.*". Ndërkohë ligji nr. 115/2016 në pikën 2 të nenit 235 të tij ka përcaktuar shprehimisht detyrimin e kandidatëve që kandidojnë për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese që deklaratën e pasurive ta dorëzojnë të plotësuar *jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë.* Po kështu, ligji nuk parashikon raste përjashtimore dhe nuk i njeh as ILDKPKI-së, as KED-së kompetencën për të pranuar deklaratën përtej afatit 15-ditor.

61. Përveç sa më sipër në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese *(shih vendimet nr. 4, datë 15.2.2021; nr. 4, datë 23.1.2017; nr. 2, datë 3.2.2009, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjithashtu, Gjykata ka nënvizuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme *(shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2015; nr. 2, datë 3.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*. Megjithatë, Gjykata ndërhyn në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016; nr. 62, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Në rastin në shqyrtim, për sa kohë që pretendimi i kërkueses për përplasjet mes akteve normative nuk lidhet me ndonjë të drejtë kushtetuese sikurse u argumentua më sipër *(shih paragrafët 37-38 të këtij vendimi)*, Gjykata vlerëson se nuk është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit.

63. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses janë të pabazuara, për rrjedhojë duhet të vendoset rrëzimi i kërkesës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.
Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.10.2022.
Shpallur më 9.11.2022.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Sonila Bejtja,Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci